




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, indo.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

I mbajtur në seancën e dhjetë (X) të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, më datë 17.7..2013 me këtë:

R E N D P U N E

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

- 2.1. Propozim vendimi për miratimin PRRU: "Livadhet e Arapit",
- 2.2. Propozim vendimi për miratimin e Kushteve të përkohshme Urbanistike-Arkitektonike dhe kushteve të ndërtimit për disa pjesë të qytetit të përfshira në PZHU të "Qytetit të Gjilani,
- 2.3. Propozim vendimi mbi taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit,
- 2.4. Propozim vendimi për miratimin e zgjidhjes urbanistike të infrastrukturës rrugore të një pjese të PDU "Qarku", vendi i quajtur "Jaruga" ZK Gjilan,
- 2.5. Propozim vendimi për miratimin e zgjidhjes urbanistike të infrastrukturës rrugore të një pjese të PRRU "Kodra e Thatë" ana e djathtë rr.Gjilan-Kumanovë,
- 2.6. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajshme komunale te tregu i gjelbër,
- 2.7. Propozim vendimi për themelimin e Komisionit vlerësues të ofertave për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim,

3. Të ndryshme,

Kryesuesi i Kuvendit
Izmi Zeka

Në punimet e seancës së nëntë morën pjesë:
Anëtarët e Kuvendit,
Drejtorët e drejtorive
Përfaqësuesi i OSB-së, z. Irfan Ukshini
Përfaqësuesi i Shoqërisë Civile Shaban Terziu

Përfaqësuesi i KVRL-së
Përfaqësuesit e Tregut të Gjelbër
Mediet

Seancën e dhjetë e hapi dhe udhëhoqi, kryesuesin i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili i përshëndeti të pranishmit, dhe kërkoi që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në këtë seancë.

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit

Nga ana e sekretarisë u konstatua se në punimet e seancës së dhjetë morën pjesë 37 anëtarë të Kuvendit, kurse munguan katër (4): Elisah Ymeri, Sabedin Kadriu, Arben Mehmeti, Jakup Bajrami

Izmi Zeka - rendi i punës është ai të cilin e kemi i propozuar, mirëpo, në seancën e nëntë nuk arritëm t' i përfundojmë dy pikat e fundit, së pari do të vazhdojmë me a dy pikë të rendit të punës nga seanca e kaluar:

2/2 Raporti Financiar Janar-Qershor 2013,

2/3 Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës së Gjilanit për vitin 2012.

Në vijim të fjalës së tij kryesuesi i Kuvendit, z. Zeka theksoi se për seancën e dhjetë i kemi 7 pikë të rendit të ditës për t' i diskutuar, por pika e cila ka të bëjë me Tregun e Gjelbër (2/6) duhet ta heqim nga rendi i punës, sepse ka pasur disa reagime, prandaj duhet të konsultohemi me ata tregtarë të cilët punojnë në Tregun e Gjelbër. Pasi që të shteren të gjitha bisedat dhe propozimet ne do ta sjellim për diskutim dhe aprovim në Kuvend.

Lidhur me propozimin e kryesuesit për heqje të pikës 2/6 e cila ka të bëjë me Tregun e Gjelbër, pati polemika dhe mospajtime në mes anëtarit të Kuvendit z. Sadudin Berisha dhe kryesuesit të Kuvendit, z. Izmi Zeka.

Ejup Haziri- ne edhe para seancës e kemi parë të nevojshme që duhet debatuar pak më tepër për çështjen e Tregut, por rendi i punës është propozuar në KPF dhe aty janë të gjithë përfaqësuesit e partive politike dhe këtë rend pune e kemi propozuar të gjithë.

Mirëpo edhe ne e kemi vërejt se ka nevojë ende të diskutohet kjo çështje, sepse i kemi pasur disa dilema dhe pajtohemi me propozimin e kryesuesit që të hiqet nga rendi i punës pika që ka të bëjë me Tregun e Gjelbër dhe të lihet edhe një hapësirë për të biseduar me të gjitha ata të cilët e sigurojnë ekzistencën në Tregun e Gjelbër dhe kur të propozohet për Kuvend të gjithë të jenë të pajtimit.

Sadudin Berisha- vazhdimisht kam thënë se po vonohet mënyra se si menaxhohet ky Kuvend.

Shqetësimet tona që i kemi ngritur edhe në KPF mbi mënyrën e dhënies në shfrytëzim të përkohshëm të Tregut të Gjelbër por vërtetohen dhe veçmas po vërtetohen nga fakti se kjo bëhet jo më shumë 3 muaj para mbylljes së mandatit të përbërjes së Kuvendit dhe askush nuk mund të justifikojë se nuk ka interesa të ngushta të individëve, grupeve të individëve dhe atyre politike.

E dyta çështja e dhënies së Tregut të Gjelbër në këtë fazë është e pajustificueshme e pa pranueshme dhe e kundërshtuar. Përbërja e re që do të del nga zgjedhjet e ardhshme do të

duhej të vendos për fatin e Tregut të Gjelbër. Ne jemi, kemi qenë dhe do të jemi që ambientit i Tregut të Gjelbër të ndryshojë në të mirë të qytetarëve dhe atyre që e marrin për shfrytëzim dhe shitje të mallrave të tyre, por kjo mënyrë si ka filluar nga ju dhe që është kundërshtuar ashpër nga ne për të cilin rast dëshmon edhe peticioni i rreth 300 shfrytëzuesve të atij tregu tregon se me të vërtetë ka interesa shumë të ngushta.

Tre muaj para skadimit të mandatit të kësaj legjislature, kërkesa e jonë ripërsëritet dhe kjo çështje jo të shtyhet, por në tërësi të anulohet si një iniciativë, përderisa nuk e kemi rezultatin e përbërjes së re të KK-së. Këtë e propozoj në emër të anëtarëve të Kuvendit të grupit më të madh politik LDK-së dhe në emër të të gjithë shfrytëzuesve të asaj hapësire të Tregut të Gjelbër.

Arben Maliqi- për neve është çdo gjë në rregull që të shtyhet kjo pikë e cila ka të bëjë me tregun dhe është mirë, sepse duhet t' i respektojmë qytetarët pa marrë parasysh a kanë të drejtë apo jo! Mirëpo komuniteti që është këtu në këtë sallë kanë një arsyeje, prandaj është mirë që të konsultohemi edhe njëherë të gjithë, kurse sot ta shtyjme këtë pikë të rendit të punës.

Sokol Haziri- unë në KPF, nuk kam qenë kur është debatuar kjo pikë, por pajtohem që kjo pikë e rendit të punës të hiqet nga diskutimi nga vendimmarrja, por një gjë duhet sqaruar se institucionet punojnë në kapacitet të plotë derisa të krijohen institucionet e reja dhe në këtë pikë unë nuk pajtohem me LDK-në, njëkohësisht nuk pajtohem as me PDK-në e cila e ka bërë këtë propozim, kurse tash kërkon për ta tërhequr, sepse paraprakisht duhet të kryhen të gjitha procedurat dhe konsultimet e nevojshme me komunitetin e tregut, por megjithatë institucionet duhet të veprojnë.

Unë po e them se po të ishte AAK iniciatore, nuk e kishim tërheq, sepse së pari e kishim analizuar mirë dhe së bashku kishim gjet zgjidhje. Nuk ka nevojë t' i bëjë askush, askujt presion, por duhet që institucionet të punojnë në kapacitete të plota dhe gjërat të shkojnë ashtu si duhet. Unë e di që tregtarët kanë të drejtë, por njëkohësisht kanë të drejtë edhe Komuna të marrë veprime të caktuara dhe nuk duhet bërë fushatë politike në këtë temë, sepse këto janë interesa të përbashkëta dhe këto interesa duhet të harmonizohen në mes të komuniteti dhe atyre që kanë të drejtë në vendimmarrje.

Unë pajtohem që kjo pikë e rendit të punës të shtyhet dhe të përpunohet mirë dhe në të ardhmen mos të kemi asnjë problem.

Izmi Zeka- unë jam për atë që nëse vetëm një qytetar është i pakënaqur jam për ta diskutuar dhe derisa të analizohet mirë, ne nuk do ta sjellim këtu. Në këtë nuk e kemi propozuar kot këtë, sepse objektivat janë për ta bërë një treg të standardeve evropiane. Mirëpo është krijuar një pakënaqësi e njerëzve dhe natyrisht se tash duhet të bisedojmë. Mirëpo duhet edhe ta dimë se deri më 3 nëntor ne duhet të marrim vendime, kurse pas 3 nëntorit vijmë zgjedhje të tjera dhe legjislaturë tjetër.

Kush është që pika 2/6 e cila ka të bëjë me tregun ta heqim nga rendi i punës, kurse me pikat tjera të procedojmë normalisht?

Aprovohet propozimi i kryesuesit që të hiqet nga rendi i punës pika 2/6: Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale të Tregu i Gjelbër, me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 13 ishin kundër.

Pas aprovimit që të hiqet kjo pikë e rendit të punës, grupi kuvendar i LDK-së i pakënaqur me këtë aprovim, në shenjë mos kënaqësie i lëshoi punimet e seancës dhe nuk i vazhduan punimet e seancës në vazhdim

Pas këtij veprimi kryesuesi i Kuvendit, kërkon që të bëhet një pushim i shkurtër prej 5 minutave.

Pas 10 minutave seanca i fillon punimet, kurse kryesuesi i Kuvendit, z. Zeka kërkon që të verifikohet edhe njëherë prezenca e anëtarëve të Kuvendit në vazhdim të punimeve të kësaj seance;

Nga sekretari u konstatua se në vazhdim të punimeve të seancës së dhjetë ishin të pranishëm 22 anëtarë të Kuvendit, kurse mungoi i tërë grupi kuvendar i LDK-së.

Pasi që kishte kuorum, kryesuesi kërkon që seanca t' i vazhdoi punimet, sipas rendit të punës i cili është propozuar, duke e hequr pikën 2/6,

Aprovohet rendi i punës me 22 vota të anëtarëve të Kuvendit.

2/2. Raporti Financiar Janar-Qershor 2013,

Nuhi Nuhiu- do të ishte mirë që në seancë të jenë të gjitha subjektet politike, por duhet të vazhdojmë me punë dhe jo të bëjmë fushatë para kohës.

Ky është në raport janar-qershor 2013 për të cilin raport materialin e keni të gjithë, por unë në pika të shkurta po ia përkujtoj.

Shpenzimi i këtij buxheti është bërë në bazë të këtij kesh plani, apo vjeljes së parasë dhe atë që e kemi planifikuar për gjashtë mujorin e parë edhe e kemi realizuar sa i përket shpenzimeve, por edhe të hyrave vetanake. Do të thotë e kemi një shpenzim në kufij të lejuar të buxhetit të planifikuar dhe i kemi 8 milion e 535 mijë €, kurse shpenzime kapitale këtë vit kemi më shumë, sepse kemi bërë investime të ndryshme 1 milion e 514 mijë €, subvencione 217 mijë € dhe kështu me radhë.

Sa i përket të hyrave vetanake, këtë vit e kemi një ngritje në disa kategori ekonomike si te tatimi në pronë, kurse në disa kategori tjera e kemi një stabilitet si të hyrat nga qiraja dhe të hyrat nga biznesi.

Po e jap një përgjigje në një pyetje për Drejtorinë e Bujqësisë, të cilën e pyetje e ka bërë grupi LDK-së dhe thonë se plani është realizuar vetëm 16%, por këto të hyra janë nga Agjensioni Pyjor dhe nuk varen nga Drejtoria e Bujqësisë e të cilat mjete i alokojnë në çdo tre muaj dhe ende nuk e kemi informatën sa mjete janë derdhur në Komunën e Gjilanit, prandaj për këtë arseje ka mbetur 16%.

Se si është bërë shpenzimi nëpër drejtori i keni tabelat për të gjitha kategoritë ekonomike dhe ato janë bërë në bazë të planifikimit dhe asgjë nuk është bërë diçka që nuk është planifikuar.

Jam i mendimit se kur ta bëjmë raportimin 9 mujor do ta kemi një gjendje edhe më të mirë edhe te të hyrat dhe te shpenzimet.

Jeni informuar ndoshta se nga Qeveria i kemi edhe 1 milion e 500 mijë €, i kemi mjete të cilat në rishikim na i kanë alokuar. Gjendja është e mirë, por do të përpiqemi që të jetë edhe më e

mirë. Çdo vit gjatë fushatave ka rënie të inkasimit të obligimeve, por në Komunë të Gjilanit vetëdija e qytetarëve është në nivel dhe kemi rritje të inkasimit.

Sokol Hziri- unë po e bëj në qëndrim të qartë të AAK-së lidhur me këtë raport, por ne që në fillim të mandatit tonë kemi sqaruar pozicionin tonë se jemi parti opozitare dhe institucionaliste e cila e pranonin vullnetin e shumicës në vendimmarrje dhe voton, prandaj ka një qëndrim të dinjitetshëm në sallë edhe pse devijimet mund të jenë të papëlqyeshme në Kuvend. Konsideroj se është shumë herët dhe është e dëmshme për qytetarët e Gjilanit që nga kjo fazë të fillohet fushatë parazgjedhore të cilën unë nuk do ta quaja të tillë, por edhe me ligj është e ndaluar dhe dihet kur fillon ajo. Për këtë arsyeje qëndrimi i ynë në sallë nuk do të thotë as qëndrim me PDK-në, por edhe dalja jashtë nuk do të thotë që do të solidarizohemi me LDK-në. Qëndrimet tona janë të AAK-së dhe i mbetemi besnik rrugës sonë.

Drejtori e paraqiti raportin dhe ne dimë përkushtimin e drejtorit për punë të mirë, sepse edhe ne do të donim që paraja të menaxhohet në mënyrën më të mirë të mundshme, sepse janë qytetarët nga të cilët grumbullohet dhe do të duhet që t' i kthen në mënyrën më të mirë të mundshme në interes të tyre. Natyrisht se ka vend që të thuhet se mund të punohet edhe më mirë dhe më me interes, por ne realisht jemi përafërsisht të kënaqur me atë që e dëgjuam. Ne dëshirojmë që kjo para të shpërndahet për pa pasur ndonjë ngjyrim politik në asnjë segment.

Ejup Haziri- edhe ne si grup kuvendar jemi për miratim të raportit, kurse AAK-në e falënderoj për konstruktivitetin që e ka pasur që nga fillimi e deri më tash.

Arben Maliqi- ne nuk pajtohemi me këtë akt të LDK-së, sepse nuk ka pasur asnjë arsyeje, sepse pati koncenzues dhe u morëm vesh që ta prolongojmë pikën kontestuese dhe nuk pati arsyeje për të dal nga salla.

Sa i përket raportit financiar, besojmë se drejtori është duke e bërë një punë të mirë, por edhe ne i bashkohemi Sokolit që me të vërtetë paraja të dedikohet aty ku ka nevojë, pa ngjyime politike dhe pa dallime fshat apo qytet.

Izmi Zeka - të deklaroheni se kush është për aprovim të këtij raporti financiar?

Aprovohet pika 2/2 e rendit të punës: Raporti Financiar Janar-Qershor 2013, me 17 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 5 ishin abstenime

2/3. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës së Gjilanit për vitin 2012.

Izmi Zeka- ky nuk është raport i Komunës, por është raport i Auditorit Gjeneral të cilin e kemi sjell sa për informacion për mos thënë se ne nuk e kemi pasur fare.

Sokol Haziri- unë desha të them atë që e tha kryesuesi, sepse ky është një informacion dhe ne nuk mund të ndikojmë te një autoritet i pavarur i Republikës së Kosovës i cili merret me këtë çështje. Iu falënderojmë për këtë informatë.

Nuhi Nuhiu- në raportin e Auditorit të Përgjithshëm ne si Komunë vetëm dy pozicione nuk i kemi plotësuar ashtu si duhet. Ato vërejtje më tepër janë aspekt teknik dhe nuk është lëndim i

bazës financiare si është fjala te regjistrimi i pasurisë, sepse zyrtari përkatës ka ngec në regjistrim. Ai zyrtar pjesën më të madhe e ka kryer, por për një pjesë të vogël na është dhënë një vërejtje. Mendoj e kemi pasur një formular për ta plotësuar unë si drejtor çështjen e vetë vlerësimit të cilin e kam marrë vonë, por edhe unë nuk e kam konsideruar si ndonjë gabim teknik, por vërejtja tjetër është te zotimi i mjeteve, sepse disa punë janë kryer pa zotim të mjeteve. Mirëpo kualifikimet për pasqyrat financiare për menaxhimin e pasurisë etje i kemi rekomandimet pozitive. Duhet ditur se Komuna e Gjilanit është një ndër më të mirat sa i përket pasqyrave financiare në tërë Republikën e Kosovës.

Këto janë disa vërejtje teknike, kurse vërejtja më serioze është te zotimi i mjeteve.

Ky raport e dini se nuk votohet, por vetëm prezantohet para anëtarëve të Kuvendit.

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, seanca dhjetë (X)

2/1 Propozim vendimi për miratimin PRRU: “Livadhet e Arapit”,

Bahrie Mamuti- ky propozim- vendim si bazë juridike e ka Statutin e Komunës së Gjilanit, miratimin e hartimit të Planit zhvillimor komunal, si dhe Ligjin e planifikimit hapësinor.

Po ashtu bazë juridike është edhe vendimi për qasje të revidimit dhe vendimi për prioritet të cilat burojnë nga Plani zhvillimor urban.

Plani zhvillimor Livadhet e Arapit (kjo pjesë) ndodhet në lindje të qytetit të Gjilanit dhe përfshin një sipërfaqe diku mbi 100 hektar. Hartuese e këtij Plani është kompania “Urban plus” nga Prishtina e cila e ka hartuar këtë plan në bashkëpunim me DUMM.

Ky Plan i ka kaluar të gjitha procedurat, prandaj iu lus që ta aprovoni, sepse kjo është në të mirë të qytetarëve të Gjilanit.

Ilir Gjinolli-(prof Ilir Gjinolli është përfaqëues i Kompanisë Urban Plus i cili me anë të kino- projektorëve e elaboroi në mënyrë detale dhe mjaft të gjatë këtë plan para anëtarëve të Kuvendit.

Sokol Haziri- unë e falënderoj prof. Ilir Gjinollin për hartim të këtij plani, sepse besoj se Iliri ka edhe një motiv shtesë për qytetin e vetë dhe ne jemi të bindur se puna është bërë me seriozitet nga kjo kompani. Natyrisht se brenga e jonë është edhe e juaja, sepse nga këto pamje të bukura, dëshirojmë që të jenë të realizueshme, sepse kostoja financiare për zbatim është mjaft e lartë. Mirëpo një çështje për të cilën kërkoj nga Drejtoria e Urbanizmit është që t’i ik atyre vijave nga kalon infrastruktura rrugore dhe pjesa tjetër e cila është publike të identifikohet më herët, kur të punohet në terren, por posaçërisht kur të miratohet në Kuvend, sepse ne e dimë që disa zhvillime shkojnë më shpejtë se sa ecim ne si pushtet dhe kjo ndodh gati gjithmonë. Kërkoj që së paku të shpëtohet ajo që është funksionale dhe që do ta bënte funksional këtë plan dhe të mos mbetemi në atë stilin e atyre rrugicave që i pamë në prezantim. Është kërkesë e të gjithëve dhe nuk është specifikë e jona, sepse nuk e di koston financiare, por siç e dini po shëmtohet edhe qyteti dhe infrastruktura me ndërtime të egra. Unë e di që Komuna nuk jep, leje, por po flas për ato ndërtimet e egra dhe krijimin e zonave informale.

Refik Hasani- unë e përshëndes projektuesin prof. Gjinollin i cili edhe më parë ka qenë i lidhur me tërë pjesën tonë (Zabel) dhe dikur kishim shumë probleme, kurse sot po bëhet një

lagje e urbanizuar. Unë e analizova me vëmendje këtë plan, por si vërejte e kam se aty na mungon në Qendër e Mjekësisë Familjare, ajo ishte paraparë, por saktësisht nuk e kam të qartë se ku është paraparë, por duhet të jetë afër impiantit i cili nuk ka punuar asnjëherë.

Pjesa e cila tash është tharë është pjesë më vitale e qytetit të Gjilanit, sepse është një hapësirë e madhe dhe e bukur për ndërtim.

Unë kërkoj që këtu të parashihet edhe ndërtimi i një stadiumi, sepse ai vend ka nevojë për një hapësirë të sportit, sepse stadiumi i qyteti është në anën tjetër të qytetit dhe në këtë stadium do të përfshihen edhe disa lagjeje të tjera të kësaj ane.

Mandej në atë pjesë bashkohen tri përroska, si Lumi Mirusha, Stanishorka, Lumi Banja, afër impiantit dhe besoj se janë të menduara mirë dhe si duhet.

Arianit Sllamniku- mua po më interesojnë disa çështje më vitale sa i përket këtij projekti.

Te Lumi Mirusha u përmend një pjesë e korridorit, ku është detajizuar se si do të bëhet çështja e ndërtimit të dy anëve, por edhe të vetë infrastrukturës së shtratit të lumit.

E dyta kjo pjesë e planifikuar për urbanizim “Livadhet e Arapit” si do të jetë gjendja e lidhshmërisë me pjesët e tjera urbanistike të qytetit që e rrethojnë këtë plan urbanistik.

Çështje më vitale për mua që i ngris është çështja e gjelbërimit, proporcioni ndërtim dhe hapësirë e gjelbëruar e cila pjesë do të ishte mirë të elaborohet. Unë këto pyetje ia shtroj profesorit dhe e falënderoj për punën që e ka bërë.

Florina Zymberi- bazuar në dokumentet e ofruara nga Kompania hartuese dhe Drejtoria e Urbanizmit lirisht mund të konkludojmë se është bërë një punë voluminoze dhe në detale e analizuar me shumë profesionalizëm. Kjo është një punë e mundimshme dhe kërkon përgjegjësi të nivelit të lartë profesional dhe human. Kur e them këtë kam parasysh se hartuesi dhe Drejtoria e Urbanizmit, por edhe ne këtu vendosim ose i caktojmë vijat e lëvizjes për gjeneratat që vijnë pas nesh. Duhet t’i dimë nevojat e popullatës për një të ardhme së paku për 30 vjet, të caktohen lëvizjet e qytetarëve për të qenë ata të kënaqur. Të vendosim për një sistem urbanistik më të organizuar dhe avancuar, kalimi nga një mentalitet anarkik, voluntar në organizim sistemor dhe të qëndrueshëm. Mund të konkludoj se në detaje janë marrë parasysh kriteret elementare si ruajtja dhe shfrytëzimi optimal i pasurisë së qytetarit, ruajtja dhe zgjerimi i lëvizjes për qytetarin, krijimi i hapësirave gjelbëruese dhe në fund krijimi i hapësirave urbanistiko-arkitektonike të qëndrueshme ndaj kohës dhe me vlera civilizuese.

Janë organizuar edhe debate me qytetarë, në të cilat debate nuk kemi munguar edhe ne anëtarët e komitetit. Të gjitha arsyet janë të qëndrueshme dhe ky plan duhet aprovuar dhe duhet të jemi sa më unanimit.

Tahir Arifi- unë do ta ngris vetëm një çështje sa i përket kësaj, sepse njohuritë që i kam unë për atë pjesë, pjesa e quajtur veriore nga hartuesit, pjesa rreth Lumit Mirusha dhe rrugës së Malishevës nga sa e di unë, një pjesë e madhe është e pandërtuar, por ajo pjesë është e parcializuar dhe njerëzit ndoshta shumë herë kanë planifikuar për të ndërtuar shtëpi, prandaj nuk e kam të qartë se kjo që na paraqitet neve këtu është në harmoni me pronarët

Mandej do të bëj një pyetje edhe jashtë kësaj teme do kërkoj që ta di nga drejtorja ku është lidhja me planet rregulluese të pjesës së Arbërisë të anës së majtë të rrugës që shkon për Preshevë, sepse duket se dikush po i paraprin zhvillimeve dhe atje ka disa zhvillime të reje dhe veçanërisht te pjesa e fundit e Tekstilit. Për këtë arsyeje do të dëshiroja të dimë se ku jemi?

Arben Maliqi- unë e përshëndes prof Gjinollin dhe po theksoj se sa i përket planeve ne Komuna e Gjilanit, jemi kampion, sepse kemi shumë, por nuk e kemi të qartë se a mund t' implementojmë këto plane rregulluese që i kemi. Sidoqoftë edhe këto e kanë anën e mirë, sepse sado kudo evidentohen ato vende dhe ruhen ato vende nga ndërtimet e egra të cilat mund të paraqiten në ndërkohë. Mirëpo unë jam optimist se këto plane rregulluese që po i bëjmë do ta kalojnë pesë vjetëshin dhe do të kthehemi prapë që ta bëjmë planin tjetër. Unë mendoj se është më mirë që t' i zbatojmë ato plane që i kemi dhe mos të kalojmë në plane të tjera.

Ky plan rregullues për mua për t' u zbatuar ka një kosto bukur të madhe financiare dhe ky plan të cilin na prezantoi profesori është një plan modern botëror i cili për mua është utopi nëse realizohet një plan i tillë në Kosovë. Mirëpo ne duhet të ecim përpara dhe jemi për aprovim të këtij plani.

Leonora Bunjaku- unë si anëtare e këtij komiteti e përkrahi Drejtorinë e Urbanizmit dhe prof. Gjinollin për punën të cilën e kemi bërë deri më tani. Mirëpo jemi të vetëdijshëm se edhe përkundër debateve që i kemi bërë me qytetarët ne ia kemi ofruar mundësinë që ta bëjmë edhe një debat tjetër me kërkesën e tyre edhe pse 76 anëtarë kanë qenë në listën e ndryshimeve të atij projekti, por të pranishëm kanë qenë vetëm 21. Sidoqoftë ne iu kemi ofruar mundësinë dhe ky plan rregullues uroj që të zbatohet dhe mbështete nga KK.

Selim Selimi- unë e përshëndes profesorin dhe të gjithë të tjerët, por unë po ndërlidhem pak me toponimin "Livadhet e Arapit" për të cilin toponim ka edhe pakënaqësi. Së pari duhet ditur se si ka ardhur deri te ky emër? Mirëpo nga informatat që unë i kam marrë nga disa qytetarë të vjetër thuhet se ky toponim ka mbetur me ndërtimin e qytetit të Gjilanit.

Në Xhaminë "Atikë" si xhamia më e vjetër e qytetit imami i parë i cili ka shërbyer në këtë xhami ka qenë me prejardhje arab, ka shërbyer në këtë xhami, ka krijuar familje, pastaj është shpërngulur në Turqi, prandaj kjo pjesë është quajtur Livadhet e Arapit. U tha këtu se duhet të bëhet ndryshimi i këtij toponimi, por unë nuk jam për atë, sepse ky toponim e ka një domethënie.

Ilir Gjinolli – po filloj nga vërejtjet e Arbenit dhe po theksoj se në ligj thotë se brenda 5 viteve plani mund të rishikohet, por nuk do të thotë që planin duhet ta mbrojmë në tërësi. Rishikimi ka kuptimin e ndryshimeve të cilat imponohen nga vendimet të cilat nuk mund të zbatohen dhe atëherë kur mendohet se bëhet zgjidhje për zbatim të planit.

Në këtë kontest as plani zhvillimor nuk është ndonjë tabu e cila nuk mund të ndryshohet, por ai duhet të jetë dinamik dhe duhet t' i përshtatet nevojave të kohës.

Sa i përket koston së implementimit, mendoj se Komuna brenda 5 viteve duhet ta zbatojë, sepse zbatimi nuk është vetëm në interes të Komunës, por edhe të individëve të cilët dëshirojnë për ta ndërtuar ndonjë shtëpi etj.

Për Lumin Mirusha është një projekt zbatues i cili i cili i merr parasysh tri komponentë: kanalizimin e ujërave të zeza, rregullimin e shtratit të lumit dhe është komponenti i tretë e cila ka të bëjë me hapësira publike e që është një korridor i dedikuar për këmbësor dhe një pjesë e madhe edhe për biçikleta.

Në vijim prof Gjinolli dhe edhe disa sqarime lidhur me planet rregulluese dhe zhvillimore në tërë Komunën e Gjilanit.

Refik Hasani- unë nuk e di sa isha i qartë në pyetjen time për lidhjen e Livadheve të Arapit me Zabelin si është lidhshmëria infrastrukturore rrugore e tanishme, sepse lagjja përmes Livadheve të Arapit duhet të lidhet me qendrën e qytetit. Lagjja Zabeli duhet të lidhet me Arbërinë dhe Malishevën.

Mandej duhet të dihet nga Drejtoria e Urbanizimit, se edhe Lagjja Zabel duhet të jetë e urbanizuar, sepse vetëm kjo lagje ende ka mbetur për pa u urbanizuar.

Ilir Gjinolli- DUMM ka qenë e kujdesshme që në të gjitha planet rregulluese në të gjitha lagjet të vendoset një lloj koordinimi dhe komunikimi që ato pika të cilat i kemi të përbashkëta, vijat kufizuese lidhjet të jenë të harmonizuara. Këtë çështje Komuna e ka zgjidh me një koordinim dhe mendoj se sa i përket kësaj çështje mendoj se nuk ka telashe.

Bahrie Mamuti-sa i përket planit të Zabelit ne e kemi miratuar vendimin për qasje dhe si drejtori, jemi duke punuar e kemi bërë analizën e gjendjes dhe presim një diskutim publik me qytetarë. Në një pjesë të lagjes kemi dal në diskutime dhe kemi bërë një propozim-zgjidhje, kurse pjesa tjetër është në vazhdimësi.

Izmi Zeka- kush është për aprovim të kësaj pike të rendit të punës?

Aprovohet pika 2/1 e rendit të punës: Propozim vendimi për miratimin PRRU: “Livadhet e Arapit”, me 23 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 1 ishte kundër.

2/2. Propozim vendimi për miratimin e Kushteve të përkohshme Urbanistike- Arkitektonike dhe kushteve të ndërtimit për disa pjesë të qytetit të përfshira në PZHU të “Qytetit të Gjilani,

Bahrie Mahmuti- si DUMM duke i pasur kërkesat e shumta të qytetarëve për zhvillimet të cilat nuk janë të mbuluara me plane rregulluese, apo janë të mbuluara me plane të vjetra të cilat nuk përputhen me zhvillimet aktuale ne kemi pasur parasysh që të bëjmë një propozim për kushtet e përkohshme urbanistike dhe të ndërtimit. Me këtë kemi analizuar situatën urbane të qytetit të Gjilanit dhe kemi ardhur deri në një konkludim i cili paraqet tërësinë e planit zhvillimor urban dhe në mënyrë të detajuar janë marrë të gjitha profilet e rrugëve të cilat atakohen me këto zhvillime. Për secilën rrugë është përcaktuar kriteri i rrugëve dhe ai i ndërtimit për sipërfaqe të cilat do të trajtohen. Kriteret ndërtimore janë marrë si bazë referente është marrë plani i qendrës dhe planet rregulluese të cilat i kemi miratuar kohëve të fundit.

Për secilin profil të rrugëve janë marrë parasysh këto standarde.

Në vijim të fjalës së saj drejtorja dhe edhe disa sqarime me anë të kino-projektorëve duke i sqaruar sipas sllajdeve.

Sokol Haziri-këto tema janë diskutuar nëpër komitete përkatëse profesionale dhe në KPF, mendoj se këto pika duhet t’i kalojmë dhe të jemi më efikas.

Ejup Haziri- pajtohem me mendimin e Sokolit se këto plane kanë kaluar nëpër procedura, janë projekte profesionale dhe unë jam për atë që të punojmë më shpejtë.

Florina Zymberi- mendoj se edhe për këtë plan drejtoria është munduar të bëjë një punë mjaft të mirë duke u bazuar në kërkesat urgjente të qytetarëve për këto pjesë dhe të cilat në të ardhmen

mund të jenë shumë urgjente. Mendoj se për këtë pikë kemi punuar shumë, jemi angazhuar edhe ne si komitet, sepse i kemi mbajtur dy takime jashtë takimeve të rregullta, kemi qenë në terren dhe kemi konsultuar qytetarë që kanë interesa për të ndërtuar në këto pjesë me të vetmin qëllim që të mos na lëshohen gabime. Kemi punuar dhe debatuar mjaft për këtë plan e cila mendoj se duhet të aprovohet, sepse interesat janë të Komunës, të qytetarëve, zhvillimit ekonomik, punësimit etj.

Arben Maliqi- ky plan i ka kaluar të gjitha sitat nga ata të cilët janë kompetent më së miri dhe besoj se kanë pasur edhe bisedime me qytetarë dhe kjo është në të mirën e qytetarëve të Gjilanit, prandaj edhe ne si grup jemi për aprovim të këtij plani.

Izmi Zeka- të deklaroheni se kush është për aprovim të këtij propozim-vendimi?

Aprovohet pika 2/2 rendit të punës: Propozim vendimi për miratimin e Kushteve të përkohshme Urbanistike- Arkitektonike dhe kushteve të ndërtimit për disa pjesë të qytetit të përfshira në PZHU të “Qytetit të Gjilani, me 22 vota të anëtarëve të Kuvendit

2/3. Propozim vendimi mbi taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit,

Bahrie Mahmuti-sa i përket këtij vendimi Drejtoria e Urbanizmit është bazuar në Ligjin e ndërtimit, ligj i cili është aprovuar në vitin 2012. Si bazë juridike është neni 22 dhe 23 të cilët nene në mënyrë decitive e obligojnë Komunën dhe Drejtorinë e Urbanizimit e cila është kompetente për menaxhim të taksës ndërtimore, ky ligj dhe udhëzimi administrativ e bënë në mënyrë të qartë se si duhet të bëhet kalkulimi i taksës administrative dhe tarifës për infrastrukturë. Kryetari i Komunës e ka formuar Komisionin i cili është obliguar sipas këtij udhëzimi të analizojë tabelën e cila po duket në sllajd.

Në vijim të fjalës së saj drejtorja i dha sqarimet për këtë taksë sipas tabelës e cila gjendet në sllajd.

Tahir Arifi- unë nuk po kuptoj në këto gjëra ose ndoshta edhe drejtorja ishte e paqartë, por unë dua ta di zbritet kjo taksë apo jo?

Bahrie Mahmuti- kjo taksë në raport me taksën e mëparshme zbritet në një masë të konsiderueshme.

Florina Zymberi- sipas një raporti të Bankës Botërore të cilin e kam lexuar, Kosova deri më tash e ka zënë vendin e katërt për nga lartësia e taksave ndërtimore. Me këtë propozim dhe me këtë ndryshim të ligjit është një çmim solid dhe e përgëzoj drejtorinë dhe të gjithë kompetentët e tjerë për këtë propozim.

Izmi Zeka- kush është për aprovim të kësaj pike të rendit të punës?

Aprovohet pika 2/3 e rendit të punës: Propozim vendimi mbi taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit, me 22 vota të anëtarëve të Kuvendit.

2/4. Propozim vendimi për miratimin e zgjidhjes urbanistike të infrastrukturës rrugore të një pjese të PDU “Qarku”, vendi i quajtur “Jaruga” ZK Gjilan,

Bahrie Mahmuti – drejtorja e Drejtorisë së Urbanizmit, këtë propozim vendim e sqaroi para anëtarëve të Kuvendit me anë të kino-projektorëve, por edhe të gjithë anëtarët e Kuvendit e kanë pasur këtë material.

Florina Zymberi- duke bazuar në gjendjen në terren dhe kërkesave të qytetarëve dhe duke u bazuar në Ligjin për planifikim hapësinor, ku thotë: “mund të ndërhyhet në zgjidhjet urbanistike në infrastrukturë rrugore, në ato pjesë ku qytetarët kanë pengesa në zhvillim të jetës normale”. Komuna nuk ka mundësi për shpronësim dhe ndërhyrje të infrastrukturës rrugore, por me këtë rast komuniteti ka dhënë deklarata është bërë zgjidhja e infrastrukturës rrugore brenda lokacionit dhe ndërlidhjet me pjesë të tjera. Do të thotë të bëhet lidhja në lokacion dhe të jetë qasje më të lehtë. Komiteti i Urbanizmit e ka aprovuar këtë zgjidhje urbanistike, sepse qytetarëve iu mundësohet qasje në objektet e tyre. Kjo është një ndihmë shumë e madhe për qytetarët.

Izmi Zeka- kush është për aprovim të kësaj pike të rendit të punës?

Aprovohet pika 2/4 e rendit të punës: Propozim vendimi për miratimin e zgjidhjes urbanistike të infrastrukturës rrugore të një pjese të PDU “Qarku”, vendi i quajtur “Jaruga” ZK Gjilan, me 23 vota të anëtarëve të Kuvendit

2/5. Propozim vendimi për miratimin e zgjidhjes urbanistike të infrastrukturës rrugore të një pjese të PRRU “Kodra e Thatë” ana e djathtë rr. Gjilan-Kumanovë,

Bahrie Mahmuti- edhe kjo propozim zgjidhje e infrastrukturës rrugore ka ardhur në diskutim në këtë Kuvend duke e pasur parasysh ankesat e shumta të qytetarëve të cilat ne si drejtori i kemi lënë dhe kërkojnë pëlqime urbanistike. Mirëpo sipas Planit urban “Kodra e Thatë,” kërkohet kompletim i parcelimeve, kurse infrastruktura rrugore nga pronarët është e trasuar.

Duke pasur parasysh këtë numër të madh të qytetarëve të cilët kanë shprehur gatishmëri që profili i rrugëve të jetë në harmoni me gjendjen ekzistuese dhe hapjes së rrugëve në terren e kemi listën e cila është me protokoll si lëndë e të cilat janë në drejtori dhe të cilat nuk kanë mund të zgjidhen deri më sot, kurse pjesa tjetër lista e qytetarëve të cilët vijnë çdo ditë në drejtori dhe i paraqesin shqetësimin e tyre për këtë zonë.

Në vijim të fjalës së saj drejtorja dhe sqarim edhe me anë të kino-projektorëve.

Florina Zymberi- duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve dhe gjendjen reale në vend, por duke e mos cenuar as Ligjin për planifikim hapësinor rregullues i cili i lejon ndërhyrjet edhe në planet rregulluese në ndryshimet e vogla të infrastrukturës rrugore dhe ndërhyrje të tjera në parcelat e propozuara nga drejtorja dhe të aprovuara nga komiteti. Me këtë akt mendojmë se jemi në shërbim të qytetarëve dhe krijimit të kushteve sa më të mira për një jetë më të mirë.

Tahir Arifi- te planet rregulluese unë gjithnjë e bëj të njëjtën pyetje; “ a janë harmonizuar me planet rregulluese, sepse nuk është kohë e gjatë kur e kemi debatuar dhe aprovuar këtë plan”?

Florina Zymberi- ligji lejon ndërhyrje të vogla dhe kur rrugët lëvizin shumë pak, këtë e lejon ligji.

Sokol Haziri- me sa jam informuar unë përfaqësuesi i jonë në Komitetin për Urbanizëm ka qenë kundër, prandaj edhe ne do ta mbajmë këtë qëndrim dhe do të votojmë kundër.

Izmi Zeka- kush është për aprovim të pikës 2/5 të rendit të punës?

Aprovohet pika 2/5 e rendit të punës: Propozim vendimi për miratimin e zgjidhjes urbanistike të infrastrukturës rrugore të një pjese të PRRU “Kodra e Thatë” ana e djathtë rr. Gjilan-Kumanovë, me 18 vota të anëtarëve të Kuvendit, 4 ishin kundër, kurse një abstenim.

Me këto vendime seanca e dhjetë e KK-së i përfundoi punimet

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA